



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 201802081/2

Tiranë ___/___/2019

Lënda: *Rekomandim për garantimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, të cilët janë të akomoduar në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Berat.*

Drejtuar: **Z. Petrit SINAJ**
Kryetar i Bashkisë

B E R A T

Znj. Luneda SUFALI
Drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror

T I R A N Ë

Për dijeni: **Znj. Alda SHULLA**
Drejtoreshë e Qendrës së Zhvillimit Rezidencial

B E R A T

Në ushtrimin e mandatit të tij kushtetues në promovimin, parandalimin e shkeljes dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të ligjshme të individëve, nga veprimet e paligjshme dhe të parregullta të administratës publike dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, Avokati i Popullit ka si prioritet të tij, promovimin dhe garantimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Aktiviteti ynë është shtrirë në disa aspekte konkrete të mbrojtjes së këtyre personave, me një qasje proaktive dhe të dedikuar, duke zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme me iniciativë, inspektime në Qendrat e Zhvillimit Rezidencial në të gjithë vendin, ku janë të akomoduar persona me aftësi të kufizuara.

Një nga këto inspektime është zhvilluar nga përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit, më datë 22.10.2018, në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial, Berat.

Avokati i Popullit, pasi shqyrtoi informacionin nga monitorimi i realizuar, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor, t’Ju parashtrojë përfundimet e këtij monitorimi, si më poshtë vijon.

Objektivat e inspektimit:

- Vlerësimi i dokumentacionit, procedurave dhe personelit, në zbatim të legjislacionit në fuqi;
- Respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, të cilët janë akomoduar në këtë qendër rezidenciale, në zbatim të standardeve ligjore të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për personat me aftësi të kufizuara.

Metodologjia

Grupi i inspektimit i institucionit të Avokatit të Popullit, i përbërë nga juristë, si metodologji pune ka përdorur:

- *Së pari*, zhvillimin e bisedave paraprake me drejtuesen e institucionit dhe shefen e financës, informacion, i cili është hedhur në një formular standart për inspektimin.

Së dyti, monitorimin e zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, sipas standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Së treti, monitorimin e mjediseve dhe kushteve të institucionit (Qendrës së Zhvillimit Rezidencial), ku ofrohen shërbime për personat me aftësi të kufizuara.

- *Së katërti*, komunikimi me disa nga personat me aftësi të kufizuara, me diagnozë “prapambetje të lehtë mendore”, përfitues të shërbimeve të përkujdesjes, të akomoduar në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial, Berat.

Profili i Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, Berat.

Qendra e Zhvillimit Rezidencial, Berat, është një qendër rezidenciale për personat me aftësi të kufizuar, nën administrimin e Bashkisë Berat dhe me mbështetje financiare të garantuar nga programet e mbrojtjes sociale të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror.

Kjo qendër ofron shërbime sipas standardeve ligjore të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara, që kanë nevojë për një kujdes afatgjatë.

Zbatimi i standardeve ligjore të shërbimeve sociale monitorohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Bashkia Berat, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Berat. Monitorimi realizohet si proces edhe nga inspektimet e kryera nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimit Social, Agjensia Kombëtare e Ushqimit, si dhe nga Drejtoria e Higjienës, Berat.

Nga informacioni i marrë gjatë inspektimit rezulton se, kjo qendër zhvillimi rezidencial ka një bashkëpunim prej 20 vitesh, me shoqatën zviceriane “ASED”. Ndërkohë, që nga muaji Prill 2018, në këtë qendër po zbatohet në bashkëpunim me shoqatën “ASED”, projekti për ngritjen e katër atelieve: *fizioterapi, hekurosje, lavanderi, kopshtari*, (Kjo shoqatë kishte dhuruar katër tavolina dhe katër hekura për atelien e hekurosjes). Ky projekt do të zgjasë për një afat kohor prej 5 vitesh.

Për më tepër, në muajin Qershor 2018, u konstatua se kishte filluar zbatimi i një projekti të ri në këtë qendër, i cili konsistonte në krijimin e një fondi financiar, për t’u përdorur për nevojat e përfituesve të shërbimeve të përkujdesjes. Të afërm dhe të njohur të stafit sillnin veshmbathje për t’i hekurosur dhe të ardhurat kalonin në fondin e institucionit. Katër të rinj me aftësi të kufizuara mendore punonin në atelien e hekurosjes, gjë që bënte që ata të ndiheshin të pavarur dhe të merrnin kënaqësi nga puna që kryenin.

Nga ky projekt, rezultoi se deri në fund të muajit Tetor 2018, ishte grumbulluar një fond prej 8000 lekësh të reja. Gjithashtu, ishin shitur 1000 kartolina dhe me të ardhurat e mbledhura nga qendra ishte blerë një kondicioner, i vendosur në mencën e katit të parë. Po kështu ishin blerë tavolina dhe karrige, të cilat ishin vendosur në ambjentet e oborrit të Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, Berat.

Numri i përfituesve nga shërbimet e qendrës

Nga konstatimi paraprak u evidentua se, në këtë qendër mund të akomodohen dhe ofrohen shërbime për persona me aftësi të kufizuar, me diagnoza dhe

grup moshë të ndryshme. Kapaciteti i qendrës për ofrimin e shërbimeve të përkujdesjes, është për 30 persona.

Gjatë inspektimit u konstatua se në këtë qendër trajtoheshin persona me aftësi të kufizuar, të grupmoshës 17 vjeç - 42 vjeç dhe ofroheshin shërbime për 26 persona. Të gjithë përfituesit ishin me ç'rregullimeve të paaftësisë mendore dhe fizike, nga të cilët 7 përfitues ishin të sëmurë paraplegjikë e tetraplegjikë. Pjesa më e madhe e tyre kishin mbi 20 vite që jetonin në këtë institucion dhe vetëm 2, apo 3 përfitues, ishin të akomoduar së fundmi.

Për çdo përfitues hartohet një plan përkujdesjeje, me anë të të cilit vlerësoheshin nevojat për shërbime nga ekipi multidisiplinar, i cili përbëhet nga:

- Drejtoresha e institucionit,
- Përgjegjësi i sektorit social,
- tre Edukatorë specialistë,
- Fizioterapistja,
- Mjeku me kohë të pjesshme,
- Kujdestari përkatës për personin me aftësi të kufizuar,
- një përfaqësues nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror.

Ky plan vlerësohet dy herë në vit nga ekipi multidisiplinar, lidhur me çështje që kishin të bënin me progresin dhe regresin e përfituesve të shërbimeve të përkujdesjes.

Një ndër rubrikat e planit të përkujdesjes, ishte edhe plan individual i shëndetit për përfituesit. Secili prej përfituesve të shërbimeve të përkujdesjes kishte kartelën mjekësore dhe medikamentet iu jepeshin sipas rekomandimeve të mjekut.

Shërbimi mjekësor realizohej nga një mjek me kohë të pjesëshme dhe nga një kujdestare infermiere. Përfituesit e shërbimeve të përkujdesjes dërgoheshin për vizita edhe në Tiranë, sipas gjendjes shëndetësore që ata paraqesnin, kohë pas kohe.

Për mbajtjen pastër të higjienës së tyre personale, përfituesve u bëhej banjë çdo ditë në mëngjes, por kishte raste edhe dy herë në ditë.

Në këtë qendër ofrohej terapi rehabilituese për personat me paralizë celebrale. Për këtë qëllim, në funksion të këtyre përfituesve, ishte vendosur një pistë ecjeje, një bicikletë statike, një pistë ecjeje me paralele, mjete këto të cilat shërbenin për reabilitimin e tyre.

Përfituesit e shërbimeve të përkujdesjes kishin realizuar shumë punime me materiale të riciklueshme, gjë që tregonte një mënyrë aktive integruese në

jetën e përditshme si dhe përkushtimin e stafit të qendrës, për krijimin e një ambienti sa më të ngrohtë dhe të përshtatshëm për ta.

Burimet njerëzore

Struktura e përcaktuar e personelit të kësaj qendre përbëhet nga 25 punonjës. Dosjet origjinale të punësimit të personelit mbaheshin në institucion.

Përshkrimet e punës së personelit janë të parashikuara në Rregulloren e Brendshme, të Organizimit dhe Funksionimit të Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, Berat, të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Berat, në datë 03.01.2018.

Trajtimin e problemeve psiko-sociale të të moshuarve, përfitues të shërbimeve të përkujdesjes në këtë qendër, e realizonin tre edukatorë specialë, të cilët hartonin planet mujore dhe ditore, si dhe një fizioterapiste.

Ndërkohë, 11 kujdestarët, të cilët merreshin drejtpërsëdrejti me personat me aftësi të kufizuar, punojnë me tre turne:

- Në turnin e parë, punojnë 5-6 kujdestarë, gjatë orarit 7.00''-14.00''.
- Në turnin e dytë, punojnë 3 kujdestarë, gjatë orarit 14.00''-19.00''.
- Në turnin e tretë, punojnë 3 kujdestarë, gjatë orarit 19.00''-7.00''.

Roja e objektit, pra i godinës dhe ambienteve të Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, Berat, i cili punonte vetëm gjatë orëve të natës, ishte emëruar dhe financohej nga Bashkia Berat.

Vlerësimi i punës bëhet një herë në vit nga drejtuesja e institucionit. Ndërkohë që stafi ishte trajnuar për shërbimet shoqërore, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Megjithatë nga konstatimet e kryera gjatë inspektimit, gjykojmë se numri i punonjësve që ofrojnë shërbime shoqërore në këtë qendër është i pamjaftueshëm, gjë që ndikon edhe në cilësinë e shërbimit të ofruar, ndaj edhe nevojitet shtimi i këtij numri, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuara.

Ambjentet e Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, Berat

Gjatë këtij inspektimi u vu re, rregull dhe pastërti në të gjitha ambientet e Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, Berat.

U konstatua se në godinën e kësaj qendre ishte bërë rikonstruksioni i korridoreve, në katin e dytë të saj. Në këtë kat gjendeshin 4 (katër) tualete, të cilat ishin të veçanta dhe të ndara, për meshkuj dhe femra. Megjithatë duhet

theksuar se tualetet nuk ishin të përshtatura në funksionalitetin e tyre, për persona me aftësi të kufizuara.

Kuzhina ishte e pajisur me një sobë industriale, e përballueshme për gatimin e nevojshëm për numrin e përfituesve të shërbimeve të përkujdesjes të akomoduar në qendër. Larja e enëve bëhej nga përfituesit, të cilët ishin persona me prapambejtje të lehtë mendore, me qëllim integrimin e tyre në procesin e përditshëm të punës në qendër.

Nga inspektimi rezultoi se, kuota financiare për shpenzimet ditore ushqimore për përfituesit që ishin mbi moshën 18 vjeç, ishte 520 lekë në ditë, ndërsa për përfituesit që ishin nën moshën 18 vjeç, ishte 500 lekë në ditë. Kampionët e ushqimeve ruheshin në frigorifer.

Marrja e vakteve të ushqimit realizohej me shërbimin catering, shërbim i cili kishte filluar që nga muaji Prill 2016. Ky shërbim ishte mundësuar nga Bashkia Berat, mbi bazën e një kontratë me afat tre vjeçar (Prill 2016 - Prill 2019) dhe ofrohej 4-5 herë në ditë. Menyja javore ishte e pasur dhe servirej e ngrohtë. Kjo menu ishte e hartuar nën kujdesin e mjekut, sipas diagnozave të përfituesve të shërbimeve të përkujdesjes, të akomoduar në qendër.

Në ambjente të veçanta të qendrës, ishin afishuar standardet e shërbimeve sociale, që duhet të respektohen nga ana e punonjësve të qendrës, gjatë punës së tyre.

“Kutia e ankesave”, ishte e vendosur në një nga mjediset e qendrës dhe hapej një herë në muaj, nga një komision i përbërë nga: përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Berat, Drejtuesi i qendrës, punonjësi social, fizioterapisti dhe një i afërm i një personi me aftësi të kufizuara, të akomoduar në qendër. Çelësi i “kutisë së ankesave”, mbahej në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

Mjetet për shmangien e rreziqeve që mund të vijnë nga rastet e emergjencave civile, ishin të vendosura në korridoret e godinës së Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, Berat. Kjo godinë ishte e pajisur me shkallët e emergjencës për evakuimin e mundshëm të përfituesve dhe të stafit.

Stafi ishte i trajnuar për përdorimin e mjeteve kundër zjarrit, ndërkohë që konstatuam që fikset e zjarrit kolaudoreshin çdo vit.

Furnizimi me artikuj hotelerike realizohej nga donatorë të ndryshëm. Nga një fasoneri në Berat, institucioni furnizohej vazhdimisht me çarçafë dhe mbulesa krevati. Ndërsa shoqata “Jezu Krishti”, sponsorizonte këtë qendër me krevate, që nga viti 2017.

Lavanderia ishte e pajisur me gjashtë lavatriçe jo-industriale dhe dy tharëse jo-industriale, të dhuruara nga donacione të ndryshme, si dhe nga Bashkia Berat, pajisje këto me të cilat mbulohehin nevojat e qendrës.

Sistemi i ngrohjes dhe i ftohjes realizohej me kondicionerë dhe me kaldajë.

Në mjediset e jashtme të Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, Berat, oborri ishte i mirësishtuar me lulishte dhe ambiente ç'lodhëse. Stafit dhe përfituesit e shërbimeve të përkujdesjes kujdeseshin për ta mirëmbajtur dhe pasuruar këtë mjedis, me shumë lule e pemë të ndryshme.

Jeta social-kulturore

Gjatë inspektimit u konstatua se, përsa i përket jetës sociale në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial, Berat, organizoheshin aktivitete të ndryshme, vizita në Kalanë e Beratit, ditëlindje, festa zyrtare etj. Organizoheshin jo vetëm ditëlindjet e personave që trajtoheshin në këtë institucion, por edhe ditëlindje të stafit të punësuar në këtë qendër. Po kështu, zhvilloheshin aktivitete të ndryshme sportive. Sipas aktiviteteve të kryera konstatohet se gjatë muajve Qershor-Gusht shkohej herë pas here në zonat e plazheve, si për shembull në Spille, Vlorë etj. Gjithashtu, gjatë vitit 2018 ishin kryer edhe vizita në qytetin e Tiranës, Krujës etj.

Përfituesit e shërbimeve të përkujdesjes në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial, Berat, të cilët kishin të afërm, vizitoheshin herë pas here prej tyre. Për takimet e zhvilluara, mbahej një regjistër, ku sejcili prind apo i afërm regjistrohej dhe shkruante përshtypjet e tij. Me kërkesë të tyre, familjarët mund t'i merrnin disa ditë në shtëpi përfituesit e shërbimeve të përkujdesjes të akomoduar në qendër.

Nga intervistimi që ju bë disa prej përfituesve, të cilët ishin me prapambetje të lehtë mendore, nga ana e tyre u shpreh se ishin shumë të kënaqur nga shërbimet e stafit të qendrës.

Problematikat e konstatuara:

- Rezulton se përfituesit e shërbimeve të përkujdesjes, të cilët janë të akomoduar në këtë Qendër, kanë ndjekur procedurën e vlerësimit nga Komisionet Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), por vlefshmëria e vendimit për përfitimin e periudhës së invaliditetit të tyre kishte përfunduar dhe ata, në periudhën e kryerjes së inspektimit, rezultonin ende të pa rikomisionuar. (Drejtuesja e Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, Berat, është shprehur se, nga inspektorët e institucioneve monitoruese iu kërkohet vërtetimi i KMCAP-it përkatës, vetëm për efekt dokumentacioni).
- Rezulton se nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore, të domosdoshme për të ofruar shërbimet e përkujdesjes shëndetësore për

përfituesit e shërbimeve të kësaj natyre, të akomoduar në këtë Qendër. Konkretisht, Qendra rezulton të mos ketë psiqiatër, punonjës social, psikologë dhe infermierë, të cilët nuk janë të parashikuar në organikën e qendrës, pozicione këto që konsiderohen thelbësore për ofrimin e shërbimeve për kategorinë e përfituesve që trajtohen aty. Në këtë Qendër detyrën e infermierit e mbulojnë kujdestarët, të cilët duhet theksuar se kanë ndjekur kurset përkatëse të formimit si infermier. Në optikën tonë, shtimi në organikë i pozicioneve me të paktën 2 (dy) infermierë, është i domosdoshëm për ofrimin e shërbimeve kësaj kategorie përfituesish, të cilët kanë nevojë konstante për ndihmë, veçanërisht në momentet e irritimit si pasojë e gjendjes së tyre fiziko-shëndetësore.

- Rezulton se Qendra nuk ka në dispozicion të saj një mjet transporti (automjet). Për çdo aktivitet të programuar të Qendrës, apo edhe për adresuar problematika të tjera që janë prezente në këto lloj institucionesh për shkak të aktivitetit të tyre specifik të përkujdesjes, transporti bëhet me mjete të tjera, me shpenzimet e institucionit.
- Konstatohet mungesa e ashensorit në Godinën e Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, Berat. Ndërtesa ka një strukturë dykatëshe dhe për këtë arsye, për të mundësuar lehtësimin në lëvizje të përfituesve të shërbimeve të përkujdesjes, vendosja e një ashensori përbën domosdoshmëri, në funksion të përmbushjes së standartve në ofrimin e shërbimeve të përkujdesjes.
- Konstatohet mungesa e aparaturave të elektroterapisë, aparatura këto të cilat mundësojnë kryerjen e procesit të rehabilitimit të përfituesve të shërbimeve të përkujdesjes, të akomoduar në këtë Qendër.
- Së fundmi, konstatohet se, tualetet që ndodhen në godinën e Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, Berat, nuk janë të përshtatura në funksionalitet për përfituesit që bëjnë pjesë në kategorinë e personave me aftësi të kufizuara. Ky fakt përben burim për gjenerimin e vështirësive/problematikave konkrete jo vetëm për këtë kategori përfituesish, por edhe për stafin e Qendrës i cili i shërben përfituesve të kësaj kategorie.

Avokati i Popullit gjykon se krijimi i kushteve të përshtatshme të jetesës për personat me aftësi të kufizuara në Institucionet Rezidenciale, duhet të jetë në fokusin e punës së këtyre institucionioneve. Sa më sipër, në funksion të

jetesës së tyre me dinjitet e në mënyrën më të mirë të mundshme, duke gëzuar plotësisht të drejtat e tyre themelore të sanksionuara në aktet ligjore e nënligjore.

Duke marrë në konsideratë konstatimet e renditura më sipër, Avokati i Popullit gjykon se pavarësisht punës rigoroze të bërë në këtë institucion, kërkohet një angazhim më i madh dhe një bashkëpunim më i mirë ndërinstytucional, ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor, për përmbushjen e standardeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara të akomoduar në Institucionet Rezidenciale.

Për këtë qëllim, për t'iu përgjigjur nevojave të aftësimin dhe zhvillimit të personave me aftësi të kufizuara, në mbështetje të nenit 21, të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave përkatëse për të mundësuar fillimin dhe përfudimin brenda një afati optimal të procesit të rivlerësimit të gjendjes shëndetësore të përfituesve të akomoduar në Qendrën së Zhvillimit Rezidencial, Berat, të cilët janë në kushtet e pamundësisë për t'u paraqitur pranë Komisioneve Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë, për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore dhe/ ose pamundësisë fizike për të lëvizur.
- Marrjen e masave për shtimin në organikën e Qendrës të pozicioneve shtesë të punës, përkatesisht, të pozicionit të kujdestarit (1), infermierë (2), psikiatër (1) dhe punonjës sociale (1).
- Marrjen e masave për vendosjen e aparaturave të elektroterapisë, aparatura këto të cilat mundësojmë kryerjen e procesit të rehabilitimit të përfituesve të shërbimeve të përkujdesjes, të akomoduar në këtë Qendër.
- Marrjen e masave përkatëse për vënien në dispozicion të nevojave të Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, Berat, të një mjeti transporti, në funksion të përmbushjes së standardeve në ofrimin e shërbimeve të përkujdesjes për kategorinë e përfituesve që trajtohen në këtë Qendër.
- Marrjen e masave për vendosjen e një ashensori, në godinën e dykatëshe të Qendrës së Zhvillimit Rezidencial për të mundësuar lehtësimin në lëvizje të përfituesve të shërbimeve të përkujdesjes.

- Marrjen e masave për përfundimin brenda nje afati optimal të përshtatshmërinë së tualeteve që gjenden në godinën e Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, Berat, për përfituesit që bëjnë pjesë në kategorinë e personave me aftësi të kufizuara të akomoduar në këtë Qendër.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar: “*Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit*”.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimin, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave personave me aftësi të kufizuara, lutemi shqyrtimin e rekomandimeve të sipërcituar.

K O M I S I O N E R

Vilma SHURDHA